

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka, në çështjen penale të akuzuarve: B. G. nga fshati A. Komuna e Prizrenit dhe A. G. nga Prizreni, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.1369/2015 të datës 18.06.2015, pas mbajtjes së seancës kryesore publike, në praninë e prokurorit shtetit Elfete Purova dhe të akuzuarve, me datë 11.09.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

B. G. nga i ati Xh. dhe e ëma F. e lindur O., i lindur me datë *data e lindjes...* në fshatin A. Komuna e Prizrenit ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, punëtor i ndërtimtarisë, i martuar, baba i dy fëmijëve, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

A. G. nga i ati B. dhe e ëma H. e lindur B., i lindur më datë *data e lindjes...* në fshatin D. Komuna e Rahovecit, tani me banim në Prizren rrugën ... nr..., ka të kryer shkollën fillore, punëtor i ndërtimtarisë, i martuar, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

Në kuptim të nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPPK.

LIROHEN NGA AKUZA

Ditën kritike me datë 01.04.2014 rreth orës 06:30 minuta, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete të pasurisë së dëmtuarit në bashkëveprim marrinë pasurinë e luajtshme të dëmtuarit F. G. dhe atë 400 shtylla të metalit me mbishkrim “F” me ngjyrë të kuqe, në atë mënyrë që i dëmtuari në oborrin e shtëpisë së tij, kishte lënë shtyllat e metalit të cilat shtylla shërbejnë për ndërtim të shtëpive, të njëjtit e tejkalojnë rrethojën e shtëpisë dhe nga oborri i marrin shtyllat e metalit, kështu të dëmtuarit i shkaktojnë dëm material.

Këso dore në bashkëveprim do të kryenin veprën penale vjedhje nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK.

Për shkak se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është provuar se të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale me të cilën akuzohen.

I dëmtuari F. (I.) G. nga fshati A. Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.1369/2015 të datës 18.06.2015, kundër të akuzuarve: B. G. nga fshati A. Komuna e Prizrenit dhe A. G. nga Prizreni, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit Elfete Purova mbeti në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar nën numrin PP/II.nr.1369/2015 të datës 18.06.2015, kundër të akuzuarve B. G. dhe A. G., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK. Qëndrimin e këtillë e arsyeton se gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor dhe seancave – procedurës së provave janë administruar provat e propozuar si në aktakuzë, është dëgjuar i dëmtuari, dëshmitari dhe të pandehurit. Prokurori i shtetit në veçanti e cek deklaratën e akuzuarit A. G. dhënë në prezencë e avokatit, pranë stacionit policor në Prizren, i cili ka pranuar fajësinë dhe në mënyrë të detajuar ka shpjeguar veprimet e ndërmarra ku së bashku me të akuzuarin B. G., konkretisht mënyrën e bartjes së shtyllave të vjedhura dhe shitjen e të njëjtave nga i akuzuari B. G., me ç'rast edhe kanë ndarë parat e fituara nga shitja. Andaj duke u bazuar në deklaratën e akuzuarit A. G., në tërësi është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktakuzës, nga del se të akuzuarit janë fajtor për veprën penale kryer në bashkëkryerje vjedhje, po ashtu propozoj gjykatës që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Në fjalën përfundimtare i akuzuari B. G. theksoj se nuk e ndjen veten fajtor pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar se është kryes i veprës penale. Deklarata e dëshmitarit dhënë në shqyrtimin gjyqësor dhe deklarata e dëmtuarit dhënë para disa seancave kanë treguar se nuk ka kurrfarë dyshim të bazuar se është kryes i veprës penale. Me asnjë provë nuk është vërtetuar se shtyllat të cilat janë objekt i akuzës kanë qenë në posedim të tij. Po ashtu theksoi se deklarata e akuzuarit A. G. dhënë para zyrtarëve të policisë, me të cilën i akuzuari ngarkohet si kryes i veprës penale në bashkëveprim, nuk mund të qëndroj pasi që deklarata e dhënë në polici nga ana e akuzuarit mund të përdoret si provë vetëm ndaj tij, pra nuk mund të përdoret si provë kundër personit tjetër – konkretisht ndaj bashkëakuzuarit, edhe pse i akuzuari A. G. deklaroi se kjo provë është marr nën masat e dhunës, për një vepër penale që nuk është kryer nga ana e tij. Andaj nga gjykata kërkoi që gjatë vlerësimit të gjitha këtyre provave dhe mbrojtjes së tij të shqiptoj aktgjykim lirues, pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në aktakuzë, veçanërisht me asnjë provë nuk është vërtetuar ndonjë veprim konkret e cila është ndërmarr nga ana e tij.

Në fjalën përfundimtare i akuzuari A. G. theksoj se gjatë tërë kësaj procedure me asnjë provë gjykata nuk ka mundur të vërtetoj gjendje e plotë faktike, sepse nuk është kryes i veprës penale, me asnjë dëshmi as nga deklarata e dëmtuarit dhe dëshmitarit nuk është vërtetuar një rrethanë e tillë. Po ashtu theksoj edhe pse është deklarata e tij dhënë në polici, ajo nuk mund të përdoret si provë sepse është dhënë në kundërshtim me dispozitat ligjore, duke e përdorur forcën pasi që procesverbali mbi marrjen në pyetje të dyshuarit nga ana e zyrtarëve të policisë është përpiluar nga ana e vet zyrtarëve të cilët kanë pasur rastin, të cilët ka dhënë vetëm që të nënshkruaj. Kjo deklaratë në këtë fazë të procedurës nuk mund të përdoret si provë, andaj propozoi gjykatës që në mungesë të provave të shqiptoj aktgjykim lirues.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat e propozuara nga ana e prokurorit të shtetit, ashtu që është dëgjuar i dëmtuarit F. G. dhe dëshmitarit A. G..

Gjykata duke e analizuar provat veç e veç dhe lidhmërinë e provave në tërësi, gjeti se nuk ka prova të cilat e arsyetojnë se në veprimet e akuzuarve B. G. dhe A. G., formohen elementet genësore të veprës penale e kryer në bashkëkryerje vjedhje nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK. Sipas qëndrimit të gjykatës nuk është vërtetuar se ditën kritike të akuzuarit në bashkëveprim në fshatin A., kanë hyrë në oborrin e shtëpisë së dëmtuarit F. G. dhe nga aty kanë marrin pasurinë e luajtshme të dëmtuarit dhe atë 400 shtylla të metalit me ngjyrë të kuqe me mbishkrim “F”, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete. Pra nga provat e administruara gjykata nuk ka mundur të vërtetoj veprimet e akuzuarve që lidhen me elementet dhe figurën e veprës penale me të cilën ngarkohen, në pajtim me dispozitat e KPPK ka shqiptuar aktgjykim lirues.

Gjithashtu gjatë analizës së provave dhe rrethanave të rëndësishme në rastin konkret siç janë: deklarata e dëmtuarit F. G. dhe deklarata e dëshmitarit A. G., gjykata nuk ka vërtetuar se të akuzuarit B. G. dhe A. G. ditën kritike kanë qenë në vendin e ngjarjes, konkretisht në vend punishten e dëmtuarit, me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve të cilat janë përshkruar në përshkrim faktik të aktakuzës. Përfundimisht, sipas qëndrimit të gjykatës me asnjë provë nuk janë vërtetuar veprimet e akuzuarve B. G. dhe A. G., që do të ishte në pajtim me figurën e veprës penale e cila do të vërtetonte elementin subjektiv – përgjegjësin penale të akuzuarve. Parimi bazë është paraparë ku vjen në shprehje parimi i ligjshmërisë e cila përcakton se personi është përgjegjës për veprimet e veta, nëse veprën penale e ka kryer me dashje, se të akuzuarit bashkërisht, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete kanë marrë pasurinë e luajtshme të dëmtuarit dhe atë 400 shtylla të metalit me mbishkrim “F” të cilat janë pronë e dëmtuarit F. G.. Në rastin konkret ky fakt nuk është vërtetuar sepse ajo që mund të thuhet pa mëdyshje është se të akuzuarit nuk kanë poseduar këto shtylla e as që është ndërmarrë një veprim hetimor nga ana e forenzikës dhe prokurorisë për vërtetimin e këtij fakti. Sepse këto shtylla asnjëherë nuk janë gjetur tek të akuzuarit, apo nuk është zbuluar se këto shtylla nga ana e akuzuarve janë shitur me qëllim të zhdukjes së gjurmëve të veprës penale. Sepse veprimet hetimore nga ana e zyrtarëve të policisë janë ndërmarrë me shumë vonesë dhe atë me rastin e zhvillimit të procedurës penale për një rast tjetër hetimor, me ç’rast të akuzuarit janë marrë në pyetje në mars të vitit 2015, pra pas një viti duke u referuar ditës kritike në të cilën thirret akuza e prokurorit të shtetit. Gjykata duke u nisur nga ky fakt dhe nga provat të cilat në asnjë mënyrë nuk kanë vërtetuar fakte vendimtare për të vërtetuar çfarëdo veprimi inkriminues të cilat janë ndërmarrë nga ana e akuzuarve, ka forcuar bindjen se në veprimet e akuzuarve nuk formohen elementet e veprës penale e kryer në bashkëveprim vjedhje nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK.

Gjykata gjatë administrimit të provave ka bërë dëgjimin e dëmtuarit F. G. edhe në cilësinë e dëshmitarit, mirëpo gjykata nga deponimi i dëmtuarit nuk ka mundur të sigurojë asnjë fakt të rëndësishëm, që kishte ndodhur në ditën kritike që lidhet me elementet e veprës penale, për faktin se dëshmitari në ditën kur ka ndodhur rasti menjëherë në mëngjes ka qenë në vendin e ngjarjes dhe ka parë se i mungojnë shtyllat e metalit të cilat i përdor gjatë punës së tij në firmën për ndërtim, por i njëjti ka vërtetuar se edhe atë ditë por edhe tani nuk e dinë se kush ka mundur të kryej këtë veprim kundërligjor në dëm të tij e as që dyshon tek dikush konkret. Po ashtu i dëmtuari në deponimin e tij theksoi se nuk dyshon tek të akuzuarit se të njëjtit nga vend punishtja ku e ka firmën dhe mban mjetet e punës të kenë marrë shtyllat e metalit. Andaj edhe gjykata vlerësoi se këto fakte nuk kanë ndihmuar në zbardhjen e çështjes, që lidhet me figurën e veprës penale të vjedhjes objekt i akuzës, me të cilën ngarkohen këtu të akuzuarit.

Sa i përket deponimeve të dëshmitarit A. G. dhënë në shqyrtimin kryesor del se ai nga i akuzuari B. G., ka marrë me qira shtyllat e metalit dhe atë në muajin mars të viti 2014 pasi që ka punuar tek djali i xhaxhait, të cilat i ka përdor gjatë punës në kryerjen e punëve ndërtimore. Vlen të

theksohet se dëshmitari këto shtylla në sasi prej 95 copë, ka marrë në muajin mars para se të ndodhë rasti respektivisht para ditës kritike kur ka ndodhur vjedhja e shtyllave në vend punishten e dëmtuarit F. G.. Andaj gjykata nga deponimet e dëshmitarit A. G. nuk ka mundur të vërtetoj ndonjë rrethanë apo veprim kundërligjor që është marrë nga ana e akuzuarve B. G. dhe A. G. në dëm të dëmtuarit, rrethana të cilat janë në pajtim me elementet e veprës penale të vjedhjes.

Këto rrethana dhe fakte lidhur me ngjarjen që kishte ndodhur ditën kritike është vërtetuar edhe nga deklarata e akuzuarve B. G. dhe A. G., dhënë në shqyrtimin gjyqësor të cilët deponime përputhen me njëra tjetrën, ku të akuzuarit e mohojnë faktin se ditën kritike kanë hyrë në vend punishten e dëmtuarit F. G. dhe nga aty kanë marrë 400 shtyllat të metalit. Nga deponimet e akuzuarit B. G. gjykata ka vërtetuar se i njëjti së bashku me vëllezërit e tij merret me ndërtimtari që nga viti 2000 dhe ai vazhdimisht ka shtylla të metalit pasi që i nevojiten për punë dhe është pjesë e punës. Gjatë punës së tij, një sasi të shtyllave diku rreth 95 copë ka dhënë në përdorim dëshmitarit A. G., me qëllim të kryerjes së punëve të ndërtimtarisë, të cilat pas një kohe i ka kthyer të akuzuarit të cilat akoma i ka në shtëpi. Nga deponimet e akuzuarit B. G. del se me A. G. njihen një kohë relativisht të shkurtër, janë takuar disa herë por nuk kanë ndonjë shoqëri të afërt. Po ashtu i akuzuari A. G. në mbrojtjen e tij tregoj për mënyrën e marrjes në pyetje nga ana e zyrtarëve të policisë dhe atë në vitin 2015 një vjet pas ditës kritike në të cilën thirret aktakuza e prokurorit të shtetit. I akuzuari po ashtu theksoj se gjatë marrjes në pyetje është nënshtruar dhunës dhe presionit psikik, me ç'rast edhe nga ana e zyrtarëve të policisë është detyruar të nënshkruaj procesverbalin e përpiluar dhe plotësuar nga vet zyrtarët, të cilën deklaratë e mohoj tërësisht në shqyrtimin gjyqësor.

Prandaj, pas administrimit dhe analizës së provave dhe atë vetëm dy provave siç janë deklarata e dëmtuarit dhe deklarata e dëshmitarit gjykata gjatë shqyrtimit kryesor këto fakte ka vërtetuar bindshëm dhe pa asnjë dilemë në mungesë të provave gjykata i lirojë të akuzuarit nga aktakuza në pajtim me nenin 364 par.1 nën par.1.3 të KPPK.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë në kuptim të nenit 463 par.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 454 par.1 të KPPK.

Nga të cekurat më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 364 par.1 nën par.1.3 të KPPK.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1247/2015 të datës 11.09.2017

Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka te drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e marrjes së njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.